



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Rev.nr.358/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Beshir Islami dhe Zenel Leku anëtarë, në çështjen juridike të paditësit S. H. nga fshati ..., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Shpëtim Sadiku nga L., kundër të paditurës L. K. I. A. P. J.S.C. V., të cilën e përfaqëson avokati Shkelzen Sopjani nga F. K., dhe L. F., me autorizim, për shkak të anulimit të njoftimit për mos përtëritje të kontratës së punës, kthimit në punë dhe kompensimit të pagave, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.8034/21 datë 13.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 29.08. 2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

PRANOHET si i themeltë revizioni i paditësit, priset aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.8034/21 datë 13.05.2024, ndërsa, lënda i kthehet kolegjit të njëjtë Gjykatës së Apelit të Kosovës në rivendosje, sipas ankesës së palës së paditur.

### A r s y e t i m i

Me pjesën e parë të dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan C.nr.480/2020 dt.21.07.2021, aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe anulohet njoftimi i të paditurës, i datës 6.03.2020 për mos vazhdimin e Kontratës së punës paditësit dhe obligohet e paditura, që paditësin në afat prej 7 ditësh nga dorëzimi i aktgjyqimit, ta kthejë në punë dhe detyrat e punës operatorë i GSE ose në punët dhe detyrat e punës që i përgjigjen

përgatitjes së tij profesionale me të njëjtën pagë mujore. Me pjesën e II të dispozitivit, obligohet e paditura të ia paguajë paditësit shumën prej 7.084,84-euro, në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar material, për shkak të mos realizimit të pagave për periodën 4.04.2020 deri më dt.6.04.2021, me kamatë ligjore prej 8% vjetore duke filluar nga dt.21.07.2021 e deri tek pagesa definitive, shumën prej 299,06 euro në emër të kamatës së llogaritur nga dita e arritjes për pagesë deri më dt.21.06.2021, në Trustin Pensional të Kosovës në emër të paditësit shumën prej 796.22-euro, si dhe shumën prej 479.16-euro në llogari të buxhetit të Kosovës në emër të tatimit në paga në emër të paditësit. Me pjesën e III të dispozitivit, obligohet e paditura që paditësit të ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 773.60-euro, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, me kërcënim përmbarimi të dhunshëm.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.8034/21 datë 13.05.2024, aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan C.nr.480/20 dt.21.07.2021 dhe çështja gjykohet si vijon: Refuzohet kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura, që paditësin, në afat prej 7 dite nga dorëzimi i aktgjykimit, ta kthejë në punë dhe detyrat e punës Operator i GSE-së ose në punët dhe detyrat e punës që i përgjigjen përgatitjes së tij profesionale me pagë të njëjtë. Obligohet e paditura që në afat prej 7 dite nga dorëzimi i aktgjykimit, të ia shpërblejë paditësit dëmin material për shkak të mos realizimit të pagave për periudhën prej 4.04.2020 deri 6.04.2021, në shumën prej 7.084.84 euro, me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga dt.21.07.2021 e deri në pagesën definitive, shumën prej 299.06 euro, në emër të kamatës, në Trustin Pensional të Kosovës, në emër të paditësit shumën prej 796.22 euro, dhe në emër të tatimit në burim në ATK, shumën prej 479.16-euro. Obligohet e paditura që paditësit të ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 773.60 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, në tërësi si e pa bazuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.8034/21 dt.13.05.2024, ndërsa, ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan C.nr.480/20 dt.21.07.2021.

Përgjigje në revizion ka paraqitur e paditura, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion , gjeti se:

Revizioni i paditësit është i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi më datën 6.04.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës së lartë cekur, për shkak të anulimit të njoftimit për mos përtëritje të kontratës së punës, kthimit në punë dhe kompensimit të pagave, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë, precizimit të saj, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Nga njoftimi për mos përtëritje të kontratës së punës të lëshuar nga e paditura, vërtetohet se e paditura e ka njoftuar paditësin se kontrata e punësimit në kohë të caktuar i përfundon më dt.4.04.2020, në përputhje me nenin 71.2 të Ligjit të Punës. Paditësi si i pakënaqur, ka paraqitur ankesë tek e paditura, për kthimin në vendin e punës. Me përgjigjen në ankesë e paditura më dt.16.03.2020 e ka refuzuar kërkesën e paditësit si të pa bazuar. Nga kontrata e punës për periudhë të caktuar, të lidhur midis paditësit si punëmarrës dhe të paditurës, si punëdhënëse, të nënshkuara më dt.28.02.2014, rezulton se paditësi me këtë kontratë, ka themeluar marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës ..., në periodë të caktuar duke filluar nga data 4.04.2014 deri 3.04.2015, me mundësi vazhdimi. Me amendamentin e kontratës së punës për periudhë të caktuar të dt.5.04.2019, me nenin 1, kohëzgjatja e kontratës së punës paditësit tek e paditura i është vazhduar deri më dt.3.04.2020 dhe se paga mujore e tij ishte në shumë prej 675.00 euro prej dt.1.01.2020. Nga vërtetimi i lëshuar nga e paditura më dt.22.03.2021, rezulton se paditësi ka punuar tek e paditura nga dt.1.07.2011 deri 3.04.2018 në pozitën ..., ndërsa, nga dt.4.04.2018 e deri më dt.4.04.2020, kur nuk i është vazhduar kontrata e punës, ka punuar në pozitën GSE – Operator, se për periodën prej dt.21.08.2019 e deri 3.04.2020, numri i punëtorëve të cilëve nuk u është vazhduar kontrata e punës tek e paditura është 51 punëtorë, ndërsa, tre punëtorëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës. Nga vërtetimi i lëshuar nga QPS në F. K., nr.250 dt.19.03.2021, rrjedh se paditësi nuk është shfrytëzues i ndihmave sociale në këtë QPS. Nga vërtetimi i Agjencisë së punësimit të Kosovës dt.19.03.2021, del se paditësi që nga mos vazhdimi i kontratës së punës nuk është duke punuar askund.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes dhe nga provat tjera të administruara, gjykata e shkallës së parë, ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në pjesën I II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të sajë.

Në procedurën ankimore gjykata e shkallës së dytë, me aktgjykimin të saj të sipër cekur, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës së paditur dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.480/20 dt.21.07.2021, ashtu që ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit S.H.,nga fshati ..., Komuna e F. K., si të pa bazuar si dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, aktualisht nuk mund të pranojë një përfundim të tillë juridik të gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi i sipër cekur i gjykatës së shkallës së dytë, është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 214 përkatësisht, nenit 182.2 pika n), lidhur me nenin 194 dhe nenin 204 të LPK-së, prandaj, për këtë shkak aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë u dashtë të priset dhe lënda t'i kthehet të njëjtës në rivendosje.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në faktin se Gjykata e Apelit e Kosovës, sikundër rezulton nga shkresat e lëndës, përkatësisht, nga vet dispozitivi i aktgjykimit të saj, duke proceduar sipas ankesës së palës së paditur, ka vendosur vetëm lidhur me kërkesën e palës paditëse për kthimin në vendin e punës dhe për kompensimin e pagave për periudhën përkatëse, por jo edhe përkitazi me kërkesën e paditësit për anulimin e njoftimit të së paditurës për mos vazhdimin e kontratës së punës të dt.6.03.2020, që po ashtu, është objekt shqyrtimi dhe se pikërisht dy kërkesat e sipër cekura të paditësit, themelësia ose jo e tyre, varen nga anulimi ose jo si i kundërligjshëm i njoftimit të së paditurës për mos vazhdimin e kontratës së punës paditësit, gjë që, u mor vesh, se gjykata e shkallës së dytë, në dispozitivin e aktgjykimit të saj, të sipër përmendur, (si pjesa qendrore, kryesore, urdhëruese e aktgjykimit), fare nuk ka vendosur për këtë kërkesë, e që në fakt është objekt shqyrtimi i kërkesëpadisë së paditësit, nga se, paditësi me padi dhe kërkesëpadi ka kërkuar, anulimin e njoftimit të së paditurës për mos vazhdimin e kontratës së punës, kthimin në vendin e punës, dhe kompensimin e pagave për periudhën përkatëse, ndërkohë që, sikundër u theksua më lartë, përkitazi me kërkesën e parë, gjykata e shkallës së dytë nuk ka vendosur fare në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Nga këtu dhe për arsyet e theksuara më lartë, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit, që kanë të bëjnë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të përcaktuara me dispozitat e sipër cekura të LPK-së.

Në rivendosje gjykata e shkallës së dytë duhet të evitohet shkeljet thelbësore të sipër përmendura, të vendos lidhur me ankesën dhe në tërësi t'i vlerësojë të gjitha thëniet ankimore, si dhe faktet me rëndësi relevante për gjykimin e plotë të kësaj çështje juridike, dhe më pas të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u sipër theksua e në mbështetje të dispozitës së nenit 223.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.358/2024 datë 29.08. 2024

Kryetar i kolegjit,  
Mr.sc. Muhamet Rexha